



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 12.08.2026 nga Z. Fran Bardhi bëjmë me dije si vijon:

Çështja është regjistruar në Platformën e Bashkëqeverisjes me nr. 937240, datë 21.04.2026, nga z. Fran Bardhi, me objekt kërkesë për shqyrtim nga struktura për ankimimet administrative pranë ASHK Drejtoria e Përgjithshme në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e kryera nga ASHK Lezhë – Mirditë - Kurbin për refuzimin e kryerjes së shërbimeve Kadastrale.

Pas verifikimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, në datën 21.04.2026 është kryer delegimi i rastit pranë ASHK-së, Drejtoria e Përgjithshme. Në të njëjtën datë, kjo e fundit ka informuar se ankesa e sipërcituar e ngarkuar në platformën e Bashkëqeverisjes nuk është në kushtet e trajtimit si ankim administrativ nga ky institucion.

Pas marrjes së përgjigjes nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme, po në datën 21.04.2026 qytetarit i është dërguar kthim përgjigje në lidhje me trajtimin e ankimit administrativ pranë ASHK Drejtoria e Përgjithshme.

Më datë 25.05.2026, qytetari rihap ankesën duke informuar se ka kryer më datë 22.04.2026 dërgimin e ankimit administrativ pranë ASHK Drejtoria e Përgjithshme me anë të shërbimit postar por nuk ka marrë përgjigje në lidhje me trajtimin.

Po në datë 25.5.2026, qytetari informohet nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme në lidhje me kërkesën nga kjo drejtori në lidhje me dërgimin e dokumentit të identifikimit, kartës së identitetit nëpërmjet shërbimit postar.

Më datë 03.06.2026, qytetari rihap ankesën duke informuar se ka kryer më datë 1.06.2026 ka kryer dërgimin e dokumentacionit të kërkuar nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme nëpërmjet shërbimit postar drejtuar kësaj drejtorie.

Më datë 22.06.2026, qytetari informohet nga platforma e Bashkëqeverisjes se ankesa po vijon trajtimin nëpërmjet platformës me ASHK Drejtoria e Përgjithshme referuar objektit të tij të ankesës që është ankim administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës dhe jemi informuar në lidhje me kërkesën nga kjo drejtori për respektimin e afatit 60 ditor të shqyrtimit të ankimit administrativ të ankesës.

Në datën 10.07.2026 qytetari është informuar nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes, për shkresën me numër protokolli 5224/3 datë 7.07.2026 drejtuar ASHK Lezhë – Mirditë - Kurbin dhe më datë 14.8.2026 qytetarit i është dërguar nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes, shkresa Kthim Përgjigje nga ASHK Lezhë Mirditë Kurbin me nr.prot 3658/1 datë 13.8.2026 në lidhje me objektin e tij të ankesës e sigluar elektronikisht nga Drejtori i ASHK Lezhë Mirditë.